

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË "AM-PM " SH.P.K.**

Sot, me datë 24/10/2022,

**Z.Roberto Vathkruja**, shtetas Shqiptar , i biri i Markut, lindur më 12/04/1996, në Shkoder/Shqiperi, banues në Tirane/Shqiperi e mbajtës i ID me nr . J60412086H , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

**Z.Eklid Meço**, shtetas Shqiptar , i biri i Ilirit, lindur më 12/04/1990, në Tepelene/Shqiperi, banues në Tirane/Shqiperi e mbajtës i ID me nr . J00412069L, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeluan një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " " Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "AM-PM" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: *Rruga "Andon Zako Cajupi", Ndërtesa nr.3, Kati 2, Ap.nr.2, Tiranë, Njesia bashkiake nr 5.*

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**



Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

*-Ndermjetesim pasurish, shitje, blerje e rikonstruksion pronash,  
-Investime ne fushen e zhvillimit te pasurive te paluajtshme , truall ,objekte ndertimore e projektim.*

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 2,200,000 (Dy milion e Dyqind mije) Leke dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z.Roberto Vathkruja, lindur me 12/04/1996**, zoteron 1 kuotë, me 50 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,100,000 (Nje milion e Njeqind mije) Leke të kapitalit themeltar.
- **Z.Eklid Meço**, lindur me 12/04/1990, zoteron 1 kuotë, me 50 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,100.000 (Nje milion e Njeqind mije) Leke të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- ●rgani administrativ i shoqërisë eshte Administratori I shoqerise :
- **Z. Eklid Meço** i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, nga 24/10/2022 – 24/10/2027, me të drejtë rizgjedhjeje.



**NENI 7**

**LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 8**


**DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë.

**ORTAKËT THEMELUES**

**Z. Roberto Vathkruja**



**Z. Eklid Meço**

